

SI MUND TË NDIHMONI PËR TË SHMANGUR TRAFIKIMIT TEK TË RINJTË, VAJZAT DHE GRATË?

Kontaktoni policinë dhe raportoni shkeljen nëse dyshoni se një fëmijë, vajzë, grua po shfrytëzohet apo shantazhohet!

Nëse njihni një të rritur që është i përfshirë në një marrëdhënie shfrytëzuese me një të ri, mos rrini indiferent! Thërrisni policinë dhe raportoni shkeljen!

Telefono 116 006 për të raportuar trafikimin dhe për të marrë informacion mbi shërbimet në dispozicion në komunitetin tuaj!

Flisni dhe ofroni mbështetje për fëmijët, gratë dhe vajzat të cilat gjenden në situatë trafikimi!

Ndërtoni marrëdhënie pozitive të hapura dhe besuese me të rinjtë, gratë dhe vajza dhe tregojuni se jeni në dispozicion për të folur nëse kanë pyetje ose kanë nevojë për mbështetje.

Përfshiheni dhe edukoni veten. Mësoni më shumë rreth sigurisë në internet dhe çështjeve të shfrytëzimit seksual dhe si të ndihmoni fëmijët dhe të rinjtë në nevojë.



Të sigurt kudo - në jetë dhe online!

MOS RRINI INDIFERENT POR KËRKONI NDIHMË


1. Linja telefonike kombëtare kundër trafikimit: **116 006;**
2. Rajoni më i afërt i policisë pranë vendit ku ndodhesh, ose kontaktoni në numrat papagesë **112 ose 129.**
3. Kërkoni ndihmë ligjore falas në numrin: **0800 1010.**



Ky publikim është mbështetur nga Projekti Rajonal për Parandalimin dhe Luftimin e Trafikimit të Qenieve Njerëzore financuar nga Ministria Federale Gjermane për Bashkëpunimin dhe Zhvillimin Ekonomik (BMZ). Përmbajtja e këtij publikimi përfaqëson mendimin e ekspertëve të Qendrës A.L.T.R.I. dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht mendimet e Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ)



MËSO MBI TRAFIKIMIN E QENIEVE NJERËZORE! MBRO VETEN GJATË PËRDORIMIT TË INTERNETIT!



**TRAFIKIMI I QENIEVE NJERËZORE
ËSHTË FENOMEN BOTËROR I CILI
SHKEL TË DREJTAT THEMELORE
TË NJERIUT DHE NDIKON NË
JETËN E MBI 25 MILIONË
NJERËZVE TË TRAFIKUAR.
DY TË TRETAT E PERSONAVE
JANË VIKTIMA TË TRAFIKIMIT
QË SHFRYTËZOHEN PËR
PROSTITUCION,
NDËR TO 70 % E VIKTIMAVE
JANË GRA DHE VAJZA.**

TRAFIKIMI I QENIEVE NJERËZORE PËRKUFIZOHET NGA KOMBINIMI I 3 ELEMENTËVE

— **Veprimtaria** e rekrutimit, transportimit, apo transferimit të viktimave të trafikimit;

— Përdorimi i metodave si kërcënim, përdorimi i forcës ose formave të tjera të shtrëngimit, rrëmbimit, mashtrimit, ose dhënia apo marrja e pagesave për të patur kontroll mbi viktimën;

— si dhe **shfrytëzimi i viktimave** për prostitucion, punë të detyruar, lypjen, përfshirje e detyruar në aktivitete kriminale, martesë e detyruar; transplantimi i organeve.

Tashmë i fuqizuar nga teknologjia, ky fenomen është më pranë nesh se kurrë!

Interneti ka ndikuar ndjeshëm në mënyrën se si funksionojnë grupet e kriminit të organizuar të përfshirë në trafikimin ndërkombëtar të qenieve njerëzore. Të mësosh si të përdorësh internetin në mënyrë të sigurt është një aftësi e rëndësishme për kohërat ku ne jetojmë!

SI NDOH REKRUTIMI DHE SHFRYTËZIMI NËPËRMJET INTERNET?

Teknologjia moderne ka mundësuar që trafikantët mund ti kontrollojnë viktimat edhe nga distanca dhe nuk krijojnë nevojën për të qenë pranë tyre!

— Përmes teknologjisë, trafikantët postojnë pozicione pune shumë të mira fitim-prurëse brenda dhe jashtë vendit;

— Trafikantët përmes një profili jo të vërtet, tentojnë të krijojnë shoqëri të ngushtë me ju, deri në propozim për martesë;

— Trafikatët mund të jenë femra, të cilat krijojnë miqësi, fitojnë besim dhe më pas nis shfrytëzimi;

— Trafikantët mund të përdorin imazhe personale të pahijshme të cilat i shpërndajnë në internet dhe me anë të tyre ju shantazhojnë.

SI DUHET TË SILLEMI PËR TË QENË TË MBROJTUR NË INTERNET?

— **Shmang ndarjen e fotove apo videove intime** në mënyrë që të mos bini pre e shantazhit apo shfrytëzimit. Nëse një material i tillë është shpërndarë online apo ju shantazhojnë me anë të tij, mos hezitoni të kontaktoni policinë. Mos lejoni të bëheni viktimë!

— **Shmang postimet në rrjetet sociale të cilat përmbajnë të dhëna personale** si: anëtarët e familjes, adresën e shtëpisë, kontaktin tuaj të telefonit, statusin e marrëdhënies suaj dhe vendet që frekuentoni. Mos ndani shqetësimet familjare në rrjetet sociale pasi trafikantët shfrytëzojnë pikat e dobëta të viktimave të tyre!

— **Shmang komunikimet apo takimet me personat e panjohur** që tentojnë të krijojnë kontakt me ju online. Ju nuk e dini se kush fshihet pas fotografisë së profilit në rrjetet sociale. **Interneti është metoda më e lehtë për të trafikuar një person!**

— **Vendosni kontrolle** prindërore për aplikacionet dhe lojrat e fëmijëve.

— **Bisedoni hapur me dike të besuar** rreth materialeve të papërshtatshme dhe pornografisë. Trafikantët targetojnë të rinjtë me qëllim rekrutimin si klientë të ardhshëm!

— Kompanitë e internetit ofrojnë nivele të ndryshme të sigurisë online, flisni me operatorët për të mësuar më shumë!

